

Selim Troci, MA¹

UDC:
355.02"20"

**MJEDISI STRATEGJIK I SIGURISË: RREZIQET NGA
KËRCËNIMET DHE MUNDËSITË E SHEKULLIT 21**

**СТРАТЕШКА СРЕДИНА НА БЕЗБЕДНОСТА: ОПАСНИ
ЗАКАНИ И МОЖНОСТИ НА 21 ВЕК**

**STRATEGIC ENVIROMENT OF SECURITY: DANGERS
THREATS AND OPPORTUNITIES OF THE 21 CENTURY**

Abstract

With the end of the Cold War, the threat of conflict between the East and the West disappeared. At this moment, there was a growing awareness for the increased interconnections and interdependence of peoples, states, regions and continents. Peace, security and development are more interconnected than ever. The initial consequences of these changes provoked a reconfiguration of the national strategies towards the creation of unions of multinational entities sharing common interests. The most explicit example of such unification is the process of EU enlargement to other European countries including the Western Balkan countries.

Security is a precondition of development; the European Security Strategy confirms. If a measure the prospects for development and successful reform according to the level of security which has been reached and according to the degree to which civilians perceive threats to their safety, the Western Balkans countries still face a myriad of both "hard" and "soft" security challenges, most notably in the areas of

¹ Kolonel, Msc. Chief Executive of Albanian Search and Rescue Centre, (selimtroci@gmail.com)

defense and security sector reform, justice and home affairs, in combating the proliferation of small arms and light weapons and establishing effective border management, not to mention such tasks as preventing potential threats of terrorism.

Predicting the future is impossible, however it would also be irresponsible not to try to identify the current trends and co-relate them with their drivers where at all possible. Today's security environment is characterized by uncertainty, complexity, rapid change, and persistent conflict. This environment is fluid, with continually changing alliances, partnerships, and new national and transnational threats constantly appearing and disappearing. Identifying, analyzing and assessing today's threats, risks and challenges are the bases for constructing a real and effective security strategy.

1. Mjedisi i sigurisë dhe strategjia

Fillimet e shekullit XXI kanë qenë dëshmitarë të qartë të zhvillimit të një mjedisi ndërkombëtar të karakterizuar nga pasiguria, paqëndrueshmëria dhe ndryshimet e shpejta në rritje. Prandaj, s'është për t'u çuditur që shumë analistë pohojnë se bota e sotme është më kaotike dhe më e paparashikueshme se në çdo periudhë tjetër të historisë. Mjedisi i sigurisë është vazhdimisht në ndryshim, me aleanca dhe partneritete të ndryshueshme, me kërcënime kombëtare dhe ndërkombëtare që ngrihen e bien.

Askund tjetër, sfidat e sotme nuk janë më të dukshme se në sferën e sigurisë kombëtare. Megjithëse rreziku i luftës globale duket i largët, shumë rreziqe vazhdojnë të jenë të pranishme, dhe po lindin me shpejtësi sfida të reja. Kërcënimet e konflikteve rajonale, përhapja e armëve të dëmtimit në masë, rreziqet e terrorizmit ndërkombëtar dhe të kimit të organizuar, problemet e dështimit të shteteve, mundësitë e zhvillimit të sulmeve elektronike dhe informative, katastrofat natyrore dhe ndikimi i ndryshimit të klimës po karakterizojnë gjithnjë e më tepër globin.

“Askush nuk mund të parashikojë të ardhmen”,² por nga ana tjetër do të ishte mungesë përgjegjësie që të mos bëhen përpjekje të gjithanshme për identifikimin dhe analizën e tendencave të zhvillimit të sotëm për të zbuluar shkaqet e tyre, për të shmangur anët negative, si dhe për të shfrytëzuar efektet pozitive të këtyre tendencave.

² Martin Van Creveld, *The Transformation of War* (New York: The Free Press, 1991), 198.

Ndërvarësia financiare globale me rrjetet e tregtisë duket se kanë frenuar mjaft konfliktet e mundshme ndërmjet shteteve me qëllim që shmangien e çrregullimeve që do të ndikonin në pengimin e tregtisë dhe në qarkullimin e kapitaleve. Globalizmi ka sjellë dhe zvogëlim të luftës ndërmjet shteteve, por konfrontimi me aktorë joshitetërorë është bërë kohët e fundit forma më e përhapur e konfliktit. Megjithatë, mundësia për konflikte ndërmjet shteteve ekziston.

Si tash ashtu edhe në të kaluarën, shtetet e dështuara dhe të brishta përbëjnë shqetësim, sepse janë burim i mundshëm i krizave humanitare dhe të stabilizimit, si dhe strehime të mundshme të sigurta për terroristët që janë përfshirë në përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e sulmeve asimetrike. Bashkëpunimi dhe konfliktet janë në themel të prirjeve kryesore gjeopolitike në botën e sotme.

Megjithëse sulmet asimetrike përbëjnë aktualisht kërcënimin kryesor të sigurisë në botë, mundësia për konflikte të armatosura nuk mund të përjashtohet. Aspiratat kombëtare, paqëndrueshmëritë rajonale dhe kërkesat (dëshirat) për të sfiduar balancën e fuqisë që aktualisht favorizon Shtetet e Bashkuara, të gjitha së bashku paraqesin shkaqet potenciale për luftë ndërmjet shteteve. Konfliktet mund të ndodhin gjithashtu në rajone të paqëndrueshme, në shtetet e dështuara dhe të brishta etj. Për rrjedhojë, vetë mundësia e konfrontimit të armatosur ndërmjet shteteve do të thotë që FA të Kanadasë duhet të përgatiten të adresojnë spektrin plotë të konflikteve.

Mjedisi i sotëm i sigurisë përmban një numër të madh kërcënimesh potenciale, kundërshtarësh dhe aktorësh me motivime të ndryshme në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Përdorimi i mjeteve asimetrike do jetë një taktikë alternative për ata që kërkojnë të shfrytëzojnë dobësitë e shtetit dhe të shmangin forcën e armatosur konvencionale dhe kufizimet e ligjeve ndërkombëtar. Zhvillimet e vrullshme të teknologjisë mund të krijojnë armiqësi ndërmjet grupeve dhe shteteve të ndryshme, duke rritur sfidat e sigurisë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare.

Përpjekjet për të kuptuar dhe parashikuar sfidat e ardhshme janë thelbësore për planifikimin efektiv në fushën e sigurisë. Në mungesë të këtyre vlerësimeve është i pamundur jo vetëm përcaktimi realist i karakterit dhe i nivelit të burimit të nevojshëm për të përballuar sfidat e ardhshme, por mund të rriten edhe rreziqet që rrjedhin nga kërcënimet.

Klauzeviç, një prej autoriteteve më të njohur për kuptimin dhe zhvillimin e strategjisë, duke studiuar fushatat ushtarake të kohës, dha

kontribut të shquar dhe të shumëllojtë në mendimin strategjik. Ai, për herë të parë, tregoi rëndësinë e lidhjes midis drejtimit politik dhe atij ushtarak, tregoi se lufta është një zhvillim social dhe akt politik njëkohësisht, duke theksuar se “lufta nuk është thjesht një akt ushtarak, por edhe një instrument real politik, një vazhdim i politikës me mjete të tjera”.³ Ai, vazhdimisht theksonte se: “strategjia ushtarake dhe politika duhet të ecin krahas njëra-tjetrës. Lufta - deklaronte ai - ka gramatikën e saj, por jo logjikën e saj”.⁴

Problemi i shtetit është ndërtimi i një strategjie të qëndrueshme dhe efektive, përballë një bote politike të trazuar. Pavarësisht nga vështirësitë për të kuptuar ndërveprimin e entiteteve politike, shteti dhe institucionet përkatëse duhet të përpiqen të kuptojnë natyrën e problemit, të parashikojnë rrjedhojat e mundshme dhe të përcaktojnë një kurs strategjik, me qëllim që të mund të arrijnë objektivin e dëshiruar. Në të njëjtën kohë, ata duhet të kuptojnë natyrën komplekse të mjedisit të sigurisë, në tërësi dhe të mjedisit strategjik të sigurisë, në veçanti, dhe të jenë të përgatitur për pengesat e papritura dhe mundësitë e paparashikuara që mund të rrjedhin prej tyre.

Pavarësisht nga vështirësitë, formulimi, zbatimi dhe rishikimi i strategjive reale, të çdo niveli, kërkon doemos analizën dhe vlerësimin e të gjithë elementeve dhe faktorëve të mjedisit të brendshëm e të jashtëm të sigurisë, për të cilin ndërtohen strategjitë.

Duke mos pasur kritere analitike të përpikta në dispozicion, vendimmarrësit veprojnë sipas pikëpamjeve të tyre për të kuptuar mjedisin e sigurisë. Ata, në përgjithësi, përdorin formulën e njohur të identifikimit të kërcënimeve dhe të rreziqeve e të ndërtimit të strategjive, duke u bazuar në skenarin më të rrezikshëm.

Ky shkrim, duke pranuar nevojën e identifikimit të kërcënimeve dhe të rreziqeve në interes të formulimit të strategjive, për përballimin e tyre, synon të zgjerojë këndvështrimin e analizës dhe të vlerësimit jo thjesht të kërcënimeve dhe rreziqeve, por të mjedisit të sigurisë në tërësi. Kështu, duke theksuar rëndësinë themelore të kulturës në përgjithësi dhe të kulturës strategjike, në veçanti, arrihet në përfundime më të sakta dhe më objektive për strategjitë që duhet të ndërtohen.

Strategjia nuk është qëllim në vetvete, por mjet për arritjen e qëllimit, ashtu siç nuk është një dokument për të zbukuruar bibliotekat dhe

³ Klauzeviç, strategjia ushtarake, vep. Vëll. I.

⁴ Klauzeviç, po aty.

tavolinat, por një burim orientimi i qartë dhe i detyrueshëm për të gjitha strukturat që lidhen me sigurinë kombëtare, sipas fushave përkatëse. Kjo do të thotë që: strategjia nuk mund të jetë një përshkrim i thjeshtë i mjedisit të sigurisë, por një strategji që pasqyron karakteristikat reale të mjedisit të sigurisë së vendit. Ajo përcakton rrugët kryesore që do të shërbejnë për ndërtimin e planeve konkrete për zbatimin e saj, meqenëse vetë strategjia nuk është plan apo dokument i zbatueshëm drejtpërdrejt.

Nuk mund të ketë strategji reale, jashtë kuadrit të mjedisit të sigurisë. Kështu që: studimi, analiza dhe vlerësimi i mjedisit të sigurisë, i kërcënimeve, i rreziqeve dhe i sfidave që ai përmban, është detyra e parë dhe baza për formulimin e një strategjie efektive. Kjo do të thotë se, ndërtimi i strategjisë duhet të paraprihet nga studime të hollësishme dhe të gjithanshme të mjedisit të sigurisë. Gjithkush mund shkruajë për mjedisin e sigurisë, gjithkush mund të trajtojë aspekte të ndryshme që lidhen me kërcënimet dhe rreziqet ose çështje që kërkojnë zgjidhje. Por, strategjia është një dokument serioz, dhe studimet e mjedisit për të cilin ajo do të ndërtohet, duhet të jenë profesionale, zyrtare dhe jo amatore.

Cilat mund të jenë prirjet që do të përcaktojnë mjedisin e sigurisë globale në të ardhmen?

Pyetja është mjaft intriguese, por jo e lehtë për ta trajtuar. Një analizë e plotë e mjedisit global, rajonal dhe kombëtar të sigurisë, me të gjithë elementet përbërës të tij, kërkon kohë, vijimësi dhe profesionalizëm, prandaj në këtë diskutim do të përqipemi të trajtojmë dhe parashikojmë kryesisht ato prirje dhe rajone që mund të kenë ndikim më të dukshëm në mjedisin e sigurisë sonë kombëtare. Megjithëse parashikimi është një çështje e vështirë dhe me rreziqe, paaftësia për të parashikuar të ardhmen nuk do të thotë se ajo është krejtësisht e panjohur.

Tendenca më e rëndësishme strategjike, që vihet re sot, është Globalizimi, me Revolucionin e Informacionit si nxitës të tij. Shoqëritë dhe kulturat po ndërlidhen me një shpejtësi që nuk është parë deri tani, disa herë në mënyrë të vullnetshme, si rezultat i zhvillimeve teknologjike, por disa herë edhe kundër vullnetit të tyre. Rezultatet e kësaj dukurie mund të jenë si pozitive (krijimi i mundësive), ashtu edhe negative (kërcënime, rreziqe, sfida).

Globalizimi është tendenca kryesore që ndryshon tablonë botërore ekonomike, kulturore dhe të sigurisë, por deri në fund të 10-vjeçarit tjetër, paqëndrueshmëria do të rritet si rezultat i ndryshimeve që do të shfaqen në strukturat e fuqisë tradicionale.

Globalizimi si një proces dinamik botëror i rritjes së shpejtë, i qarkullimit ndërkufitar të mallrave, të shërbimeve, të parave, të njerëzve, të teknologjisë, të ideve, të kulturave, të vlerave, të kimit dhe të armëve do të vazhdojë të ketë një ndikim kryesor mbi rendin e sigurinë, duke thelluar ndërvarësinë, duke forcuar pozitat e disa aktorëve dhe duke dobësuar ato të disa të tjerëve. Për më tepër, ndikimet e tij përfshirë terrorizmin dhe krimin e organizuar, do të vazhdojnë të bashkëveprojnë me rivalitetet rajonal dhe etnik, duke rritur rivalitetin dhe paqëndrueshmërinë në sistemin ndërkombëtar.

Sipas përcaktimit të Strategjisë së Sigurisë Evropiane,⁵ siguria është parakusht i zhvillimit. Në qoftë se i matim perspektivat dhe reformat e suksesshme sipas nivelit të sigurisë që është arritur dhe shkallës së perceptimit të qytetarëve për sigurinë e tyre, Ballkani Perëndimor vazhdon të karakterizohet nga një pamje jo shumë e qartë, pavarësisht nga përfundimi i konflikteve të viteve 1990 dhe rritjes së qëndrueshmërisë së rajonit.

Vendet e Ballkanit vazhdojnë të ballafaqohen me një sërë sfidash sigurie në fushën e mbrojtjes dhe të sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe të punëve të brendshme, në luftën kundër përhapjes së armëve të vogla dhe të administrimit efektiv të kufijve, pa përmendur parandalimin e kërcënimeve të mundshme të terrorizmit.

Ndërsa vendet demokratike synojnë të çojnë përpara ekonominë, demokracinë, shoqërinë civile dhe shtetin ligjor, ato ballafaqohen me paqëndrueshmërinë që rrjedh prej problemeve ekonomike, politike dhe të qeverisjes. Gjithashtu, ato do të sfidohen edhe nga ideologjitë radikale, regjimet e korruptuara, pikëpamjet e kundërta për rendin botëror, si nocioni i “demokracisë sovrane”, i mbështetur kryesisht nga Rusia dhe Kina, të cilat e shohin mbështetjen amerikane për demokracinë dhe të drejtat e njeriut si një ndërhyrje në punët e brendshme të shteteve sovrane. Në këto kushte, paqëndrueshmëria ka mundësi të përbëjë tiparin kryesor për një të ardhme të parashikueshme.

Rënia e regjimit të vjetër krijoi mundësi të papara për rritjen e ndikimit dhe të fitimit të grupeve të ndryshme politike dhe ekonomike, e shpesh këto grupe kryesojnë drejtimin politik, shpërndarjen e të ardhurave dhe privatizimin. Shtetet më të suksesshme kanë arritur t'i rregullojnë këto procese dhe të kontrollojnë grupet konkurruese, ndërsa shtetet e dobëta jo vetëm nuk kanë mundur ta bëjnë këtë, por shpesh

⁵ Centre for European Policy Studies (CEPS), Brussels, March 2016.

politika e tyre është një zgjatim i luftës së konkurrencës së këtyre grupeve, ku fitimtari kontrollon fitimet.

Evropa parashikohet që të ketë qëndrueshmëri relative, pavarësisht se disa tensione, si p.sh., në Ballkan, mund të çojnë në konflikt. Pikëpamjet e ndryshme në lidhje me zgjerimin dhe rregullimet institucionale të BE-së, ashtu si edhe problemet sociale dhe ekonomike, të përkeqësuar nga plakja dhe rënia e numrit të popullsisë në shumë vende anëtare, do të dobësojnë politikën e konsensusit lidhur me politikën e mbrojtjes dhe me atë të jashtme.

Evropa është e interesuar të merret më shumë me problemet e saj, dhe politikat e saj do të vazhdojnë të reflektojnë debatin midis opinionit mbizotërues që favorizon lidhje të ngushta ndëratlantike dhe atyre që kërkojnë një "Identitet Evropian" më të fortë, si kundërpeshë ndaj fuqisë amerikane. Zgjerimi i Bashkimit Evropian, sidomos përfshirja e Turqisë, mund të krijojë të çara midis shteteve kryesore të tij. Marrëdhëniet si të SHBA-ve dhe të Bashkimit Evropian me Turqinë mbeten të tensionuara dhe në një udhëkryq strategjik.

Pozicioni i qëndrueshëm e i njehsuar i Evropës, në lidhje me çështjet sfiduese të sigurisë, do të jetë i paqartë, ashtu siç do të jetë e paqartë edhe çështja e partneritetit me SHBA-të për operacione të veçanta ushtarake, sidomos jashtë Evropës. Në çështjet e sigurisë në Evropë përfshihen probleme, si: rritja e trafikeve të armëve, të drogave dhe të njerëzve përgjatë korridoreve juglindorë të saj. Tensionet e pazgjidhura në lidhje me Kosovën, Bosnjë-Hercegovinën dhe në disa zona ish-sovjetike, mund të shkaktojnë konflikte. Shqetësime ekzistojnë edhe në lidhje me besueshmërinë e Ruisë, si furnizuese e energjisë dhe tendencën e saj, për ta përdorur atë si instrument për presion politik.

Në Evropë, kërcënimi kryesor sot është terrorizmi në zonat e mëdha urbane, ndërsa ndikimi psikologjik, në rast të përdorimit të armëve të dëmtimit në masë, është vështirë të parashikohet. Efektet pasuese mund të përfshijnë paqëndrueshmërinë ekonomike, tensionet etnike ndaj komuniteteve myslimane në rritje në Evropë, orientimin në çështjet e sigurisë së brendshme evropiane dhe shqetësimet ndaj reagimeve të mundshme amerikane.

Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë, ndër të tjera, shqyrton edhe mjedisin e sigurisë, kërcënimet dhe rreziqet, të cilat, nëse nuk parashikohen, analizohen dhe vlerësohen dhe nëse nuk planifikohet parandalimi ose përballimi i tyre, ato mund të dëmtojnë interesat dhe sigurinë kombëtare. Një politikë e studiuar mirë dhe e veçantë me çdo

shtet, është një nga kushtet themelore për krijimin e një mjedisi sigurie të qëndrueshëm dhe rrjedhimisht, për rritjen e sigurisë kombëtare.

Strategjia vë në dukje një sërë rreziqesh, që në një kohë të caktuar, mund të shndërrohen në kërcënime, si: krimi i organizuar, terrorizmi, trafiqet e paligjshme, paqëndrueshmëria politike, zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik, emigracioni etj. Të gjitha vendet anëtare të NATO-s dhe të BE-së ballafaqohen me rreziqe në shkallë të ndryshme, dhe rrjedhimisht, duhet të reagojnë në mënyra të ndryshme, gjë që përbën një kontrast në krahasim me periudhën e Luftës së Ftohtë, kur kërcënimi dhe reagimi ishin, pak a shumë, të njëjta për të gjithë. Kjo do të thotë që një aleancë e sotme duhet të plotësojë nevoja të ndryshme të sigurisë për secilin anëtar dhe jo thjesht, nevojën e zakonshme të Luftës së Ftohtë.

Kjo tregon që kërcënimet dhe rreziqet duhet të analizohen sipas intensitetit dhe ndikimit të tyre në sigurinë e vendit. Çështja e emigrimit, në një të ardhme jo të largët, do të shoqërohet me pasoja jo vetëm për zhvillimin e vendit, por edhe për sigurinë e tij, nëpërmjet zvogëlimit të popullsisë dhe plakjes artificiale të saj. Mungesat në kontrollin e kufijve çojnë në një sërë dukurish me ndikim negativ për sigurinë, si: krimi i organizuar, trafiqet, lëvizja e pakontrolluar e njerëzve dhe e mallrave, duke u dhënë atyre një karakter ndërkombëtar.

Megjithëse mjedisi i sigurisë në rajonin e Ballkanit është shumë më i ndryshëm nga më parë, ai akoma nuk e ka arritur nivelin e një paqeje të qëndrueshme dhe pozitive. Duke mbajtur parasysh se koncepti i sigurisë ka marrë një sërë kuptimesh dhe nuk mund të kufizohet vetëm me sigurinë ushtarake, rajoni akoma ka një sërë çështjesh sigurie.

Një nga çështjet më të dukshme sot është ekzistenca e nacionalizmit etnik në shumë vende. Lidhur me këtë, është edhe çështja e kufijve të diskutueshëm, siç mund të shihet në problemet midis Kosovës dhe Serbisë, por edhe më gjerë. Historia botërore tregon se, vetëm në rajonet ku nuk ka mosmarrëveshje dhe diskutim për kufijtë, mund të ketë paqe të qëndrueshme. Në fakt, është mungesa e çështjeve territoriale që ka çuar në projektin e integritit në Evropë, një shembull i qartë i një komuniteti sigurie. Prandaj duhet të mendohet se zgjidhja e çështjeve kufitare është një kusht i domosdoshëm për paqen dhe sigurinë.

Ndarjet etnike, megjithëse në kuadrin e sistemeve politike të hapura nuk janë në gjendje të zhvillohen, me veprimet e tyre, ndikojnë në dobësimin e legjitimitetit dhe të forcës së shtetit, dhe shtetet e dobëta kanë vështirësi në ndërmjetësimin për zgjidhjen dhe frenimin e tyre.

Rajoni i Ballkanit karakterizohet, në shkallë të ndryshme, nga problemet etnike. Disa herë po vihet re një gjallërim i këtij problemi edhe në Shqipëri, një nxitje artificiale, por sidoqoftë me pasoja jo vetëm për marrëdhëniet ndërshtetërore, por për një siguri të qëndrueshme të vendit.

Pavarësisht se koncepti i sigurisë është zgjeruar, ai përsëri përmban elemente shumë të rëndësishme ushtarake. Në këtë rast, kërcënimet ndaj sigurisë do të kërkojnë një reagim ushtarak shumë më të ndryshëm nga ai i kohës së mëparshme. Forcat e Armatosura duhet të jenë më të afta dhe më elastike, që do të thotë dhe më të kushtueshme. Por, për të mos rritur tej mase shpenzimet e mbrojtjes, ushtritë duhet të jenë më të vogla. Kjo do të thotë që vendet e vogla nuk mund të jenë në gjendje të ndërtojnë forca të armatosura që të kryejnë çdo funksion në një konflikt ushtarak, gjë që nënkupton përparësinë e roleve, por dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në aleanca.

Reformimi i Forcave të Armatosura duhet të përfshijë të tre dimensionet: atë konceptual (doktrinar), strukturor dhe në pajisje e teknikë. Nuk mund të ketë reformë ushtarake, në qoftë se mungon qoftë edhe një nga këto dimensione. Ndryshimet thjesht strukturore, që janë vërejtur rëndom për një kohë të gjatë, aq më tepër për një ushtri të vogël, nuk ndryshojnë gjë në thelb dhe akoma më keq, nuk lejojnë arritjen e qëndrueshmërisë, zhvillimin e përvojave të përparuara dhe krijimin e traditës, pa të cilat ushtria nuk mund të jetë efektive në kryerjen e misionit të saj.

Kjo kërkon që çdo ndryshim apo dokument që përpilohet, si: Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Strategjia Ushtarake, Planifikimi, Zhvillimi dhe Përhapja e Forcave të udhëhiqen nga studime të plota, përndryshe, këto dokumente nuk do të shërbejnë si udhëheqëse në veprimtaritë konkrete. Kjo kërkon që vendi dhe ushtria të kenë organizma të veçantë, me ekspertë të fushave për të studiuar në vazhdimësi mjedisin e sigurisë. Ata duhet të paraqesin studime në lidhje me strategjinë e sigurisë dhe atë ushtarake për zhvillimin e forcës, dhe vetëm mbi këtë bazë mund të themi se mund të ndërtohen strategji reale.

2. Zhvillimi ekonomik-shoqëror dhe ndikimi në sigurinë kombëtare

Prirjet negative në ekonomi, demografi dhe mirëqenie mund të shërbejnë si burim tensioni tek vendet ku janë mjaft të përhapura pakënaqësia, pabarazia dhe mungesa e perspektivës. Këto prirje destabilizuese mund të rezultojnë në kriza humanitare ose në formë të rënda të cenimit të rendit kushtetues, të paqes dhe të mjedisit të sigurisë.

Në studimin e saj të perspektivës globale – skenari kryesor i Bankës Botërore parashikon që prodhimi ekonomik global në vitin 2030 do të jetë rreth 72 trilion dollarë amerikan, nga 35 trilion dollarë amerikan që ishte në vitin 2005.⁶ Kjo rritje ekonomike do të nxitet nga rritja e popullsisë, përmirësimet në prodhim dhe nga integrimi më i madh i ekonomisë.

Së bashku me rritjen e popullsisë, rritja ekonomike do të përqendrohet në vendet në zhvillim, të cilat parashikohet të kenë një rritje mesatare prej 4.3 për qind në vit deri në vitin 2030.⁶ Ndërsa Shtetet e Bashkuara ka mundësi të mbeten edhe për shumë kohë ekonomia më e madhe e botës, Kina India dhe Brazili do të rrisin në mënyrë dramatike nivelin e tyre ekonomik.

Pabarazitë ekonomike rajonale, ka të ngjarë të rrisin prirjen për dhunë ndërmjet shteteve dhe këtë mënyrë mund të jenë një shtytës për konflikt dhe luftë. Një vend me rritje ekonomike të shpejtë mund të joshet që të drejtojë pasurinë e tij të re në agresion, duke u përpjekur të arrijë objektiva që më parë ishin të pamundura e të perealizuara. Po ashtu, një shtet më i fuqishëm por me rritje ekonomike të ngadalshme mund të frikësohet që pozicioni i tij mund të arrihet dhe të lihet pas nga një vend tjetër, ekonomia e të cilit rritet me ritme të shpejta. Ritmet e ndryshme të rritjes ekonomike mund të krijojnë dhe heqin shanset për shtetet që shpresojnë të ruajnë ose përmirësojnë pozicionin e tyre në skenën ndërkombëtare. Megjithatë, ndryshimet e mëdha e të menjëherëshme ekonomike dhe thellimi i pabarazisë mund të shkaktojnë konflikt ndërmjet vendeve të zhvilluara apo në zhvillim.

Në botën e zhvilluar nuk pritet të ketë rritje të popullsisë, ose ajo mund të jetë më e vogël, nga ana tjetër, popullsia e vendeve në zhvillim do të vazhdojë të rritet. Rekrutimi prej vendeve të zhvilluara, i fuqisë punëtore të aftë nga vendet në zhvillim, pritet të vazhdojë, meqenëse vendet e zhvilluara synojnë të adresojnë pasojat që vijnë nga plakja e popullsisë. Kjo parashikohet të shkaktojë një migrim më të madh se ai normal në botën zhvilluar, qoftë ky legal dhe jo legal, dhe këta qytetarë të rinj ka të ngjarë të vazhdojnë të ndryshojnë strukturat shoqërore, politike dhe ekonomike të shoqërive të cilave ato i bashkohen.

⁶ Department of Defense, The National Defense Strategy of the United States of America (Washington, DC: Department of Defense, March 2017).

Popullsia e parashikuar e mega-qyteteve në vitin 2025
Popullsia e grumbullimeve urbane

Nr.	Qyteti	Shteti	Milion banorë
1	Tokio	Japoni	36.4
2	Bombej	Indi	26.4
3	Delhi	Indi	22.5
4	San-Paolo	Brazil	21.5
5	Meksiko Siti	Meksikë	21.0
6	Nju Jork	SHBA	20.6
7	Kalkuta	Indi	20.6
8	Shangai	Kinë	19.4
9	Karaçi	Pakistan	19,1
10	Kinshasa	R. D. Kongos	16.8
11	Lagos	Nigeri	15.8
12	Kajro	Egjipt	15.6
13	Manila	Filipine	14.8

Nr.	Qyteti	Shteti	Milion banorë
14	Pekin	Kinë	14.8
15	Buenos Ajres	Argjentinë	13,8
16	Los Anxhelos	SHBA	13.7
17	Rio De Zhaniero	Brazil	13.4
18	Xhakarta	Indonezi	12.4
19	Stamboll	Turqi	12.1
20	Guanxhou	Kinë	11.8
21	Osaka-Kobe	Japoni	11.4
22	Moskë	Rusi	10.5
23	Lahore	Pakistan	10.5
24	Shençen	Kinë	10.2
25	Madras	Indi	10.1
26	Paris	Francë	10

Burimi: Kombet e Bashkuara, e ardhmja e urbanizimit të botës: 2007

Fatkeqësitë natyrore apo shpërthimet e luftës mund të shkaktojnë shpërngulje masive të njerëzve në rajonet e afërta dhe nganjëherë matanë kufijve dhe shpesh në zona me kapacitete të kufizuara ose që s'kanë mundësi për tu përballur me tensione të reja të papritura. Lëvizje të tilla masive mund të përhapin e sjellin destabilitet politik dhe shoqëror si dhe të përhapin konfliktin në zona më të gjera. Për më tepër, refugjatët dhe grupet e zhvendosura brenda vendit, shpesh të imponuar të jetojnë në kushte jo higjienike dhe me dendësi të madhe popullore, janë të prirur për sëmundje ngjitëse, që mund të përhapen me shpejtësi.

Sipas raporteve të Kombeve të Bashkuara, deri në fund të 10 vjeçarit të ardhshëm, në zonat urbane do të jetojë 60 për qind e popullsisë së botës, ndërsa në vitin 2050 ajo do të arrijë 70 % të saj.⁷ Një rrjedhojë tjetër e urbanizimit global është rritja e mega-qyteteve, grumbullimeve urbane të më shumë se dhjetë milion banorëve. Në vitin 2007, në botë kishte 19 mega-qytete, ndërsa në vitin 2025 numri i tyre parashikohet të arrijë në 27 të tillë. Deri në vitin 2025, në mega-qytete do të jetojnë rreth 10 për qind e popullsisë, ndërsa 80 për qind e këtyre mega-qyteteve të parashikuara, do të ndodhen në vendet në zhvillim. Këto qytete, që realisht edhe sot janë shumë të mëdhenj meqenëse gjatë dekadave të ardhshme mbushen më tej nga vërshime të mëdha banorësh, zona të konsiderueshme të tyre do të jenë të varfra, të mbipopulluara, të ndotura dhe me shërbim të dobët transporti dhe strehimi.

Rritja e mega-qyteteve shtrojnë një sërë problemesh në fushën e sigurisë. Për faktin se pjesa më e madhe e qendrave të banuara gjenden në vendet në zhvillim, këto do të vuajnë nga mungesa e infrastrukturës së strehimit, çfarë do të thotë që shumica e popullsisë së varfër do të banojë në lagje të varfra që kanë mungesa në shërbime bazë profilaktike. Mega-qytetet do të krijojnë një tendosje të madhe në institucionet shtetërore dhe ato lokale. Banorët në shtetet e dështuara dhe të brishta ka të ngjarë të përjetojnë mungesën e shanseve ekonomike, infrastrukturë të pamjaftueshme, ekspozimin ndaj sëmundjeve ngjitëse dhe grabitjeve kriminale.

Qendrat e mëdha urbane mund të shndërrohen në fushëbeteja, aty ku strehohen kriminelët, terroristët, dhe kryengritësit nga ku ata mund të organizohen dhe të hidhen në veprim. Mangësitë dhe problemet e krijuara në qytetet e mëdha për shkak të paaftësisë së qeverisë për të siguruar shërbimet themelore ose të vakumit të qeverisjes vetëm do të

⁷ Raport i Kombeve të Bashkuara 2017.

përkeqësojnë krizat humanitare, do të krijojnë cenueshmëri nga ekstremizmi politik, do të rrisin kërkesën për stabilizim dhe rindërtim përmes ndërhyrjeve, dhe përkeqësojnë paligjshmërinë, që ndihmon në strehimin e lehtësimin e punës së kriminelëve, terroristëve dhe rebelëve.

Globalizmi, urbanizimi i shpejtë, transportimi masiv, ndryshimi klimës dhe ndryshimi i sjelljes shoqërore, të gjitha këto kanë mundësi të rrisin prekshmërinë nga sëmundjet dhe përhapja e tyre. Lehtësia dhe mundësia e udhëtimeve ajrore mundëson lëvizjen e shpejtë të njerëzve, kafshëve dhe produkteve nga një anë e globit në anën tjetër të tij, për rrjedhojë çdo sëmundje që mbartet nga këto transportues mund të përhapet lehtë në zona ku më parë sëmundja nuk ishte prezente dhe tipike.

Lëvizja dhe qarkullimi i lehtë i njerëzve dhe e produkteve të mishit krijojnë rrezikun e përhapjes së sëmundjeve të tilla rreth botës brenda një periudhë shumë të shkurtër kohe. Vendet në zhvillim kanë mungesa në fondet për kujdesin shëndetësor, spitale, pajisje, në inventarin e vaksinave dhe në punonjës të kualifikuar të shërbimit shëndetësor.

Problemi kryesor në epidemitë dhe pandemitë është se ndikimet e tyre ekonomike, demografike dhe politike mund të jenë të rënda, pavarësisht nga fakti nëse viktima është një shtet i zhvilluar apo në zhvillim. Për me tepër, për shkak të globalizimit, është tepër e vështirë të kontrollosh përhapjen e sëmundjeve ngjitëse në botën e sotme të ndërlydhur dhe udhëtimeve të dendura në gjithë botën, dhe është akoma më e vështirë të parashikosh shpërthimet e ardhshme të sëmundjeve të tilla.

Sipas një raporti të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Social, në vitin 2015, rreth 735 milion njerëz jetojnë në varfëri ekstreme (jetese me më pak se një dollar në ditë).⁸ Shumica e vendeve në Afrikë nuk kanë bërë progres në zhvillimin ekonomik. Shumë faktorë pengojnë arritjen e qëllimit të çrrënjësjes së varfërisë, dhe këto janë dominuese në botën në zhvillim. Konfliktet e armatosura përforcojnë këtë varfëri dhe largojnë vëmendjen e financimet e qeverisë nga zgjidhja e problemit. Afërsisht 40 për qind e konflikteve në botë ndodhin sot në kontinentin e Afrikës.

Dështimi për çrrënjësjen e varfërisë në Afrikë nuk është një shenjë e mirë për të ardhmen, veçanërisht në lidhje me çështjet e sigurisë. Rezultat i kësaj mund të jenë migrimet masive, meqenëse njerëzit lënë rajonet e varfra apo të shkretuara nga lufta në kërkim të burimeve më të mëdha ose shanseve më të mira të punësimit. Një

⁸ Raport i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për zhvillimin social, viti 2015.

vërshim masiv i njerëzve mund të krijojë një krizë humanitare ose një konflikt etnik ku njerëzit e pakënaqur, të lënduar dhe zemëruar mund të shpërthejnë konflikte të brendshme me kryengritje, rebelime ose protesta në lidhje me pabarazinë ekonomike dhe mungesën e burimeve.

Mjedisi ardhshëm i sigurisë rajonale e globale do të karakterizohet nga konfliktet potenciale shtet me shtet, nga kërcënimet asimetrike gjithnjë në evoluim, nga aktorët jo shtetërorë dhe shtetet e papërgjegjshme, dhe nga problemet shoqërore, ekonomike, mjedisore dhe të burimeve që mund të çojnë në një gjendje të paqëndrueshme. Shtetet e pranojnë që mirëqenia ekonomike, tregtia ndërkombëtare dhe Armët e Dëmtimit në Masë janë frenues (përmbajtës) të rëndësishëm për konfliktet ndërmjet shteteve, por megjithatë tensionet që lindin nga konkurrenca ekonomike, shoqërore dhe e burimeve do të ekzistojnë gjithnjë dhe mund të motivojnë sulmet shteteve të tjera.

Ekzistenca e vazhdueshme e shteteve të dështuara dhe të brishta do të thotë që rajone të tilla të paqeverisura apo qeverisura dobët do të vazhdojnë të shërbejnë si strehë e sigurt për organizatat terroriste dhe kriminale. Kjo nënkupton gjithashtu që rajone të tilla mund të bien në kaos, duke kërkuar në këtë mënyrë misionë humanitare, stabilizimi apo rindërtimi për të përmirësuar situatën e sigurisë. Papunësia, varfëria, efektet e ndryshimit të klimës, dhe mungesa e burimeve, ka mundësi të përkeqësojnë dhe gjenerojnë destabilitet, që mund të çojë në kriza humanitare apo stabilizimi përderisa rajonet e varfëruara dhe rrënuara luftojnë me migrimin masiv, popullsia e zhvendosur dhe konkurrimin për ushqim, ujë dhe burime të tjera.

Për mjedisin e ardhshëm të dhënë të sigurisë, hapësira e luftës së ardhshme bën të nevojshme operacionet në vend dhe jashtë vendit në hapësirat e luftimit fizik ose “elektronik”, në zonat urbane bregdetare, ose në terrene të veçanta, ku të gjitha mund të përfshijnë mjetet dhe armët konvencionale dhe asimetrike.

CONCLUSIONS

National security is a precondition and a necessity for a country's economic, cultural and social development. If perspectives and reforms are measured by the level of security that has been achieved and the degree of threats to security, then we can say that the Balkan states and all of them face security challenges.

These challenges are related to security, growth of welfare, development of institutionalized Europeanization reforms, strengthening of human rights and freedoms, media independence, fight against corruption, fight against illegal trafficking, etc.

Today's global and regional security environment is characterized by uncertainty, complexity, rapid change, and constant conflict. The environment is unsustainable, with ever-changing partnership alliances and national and international threats that arise and disappear without interruption. Identifying, analyzing and assessing threats, dangers and challenges today is the foundation for building a real and effective National Security Strategy.

Negative trends in the economy, demographics and well-being can serve as a source of tension and dissatisfaction at places where dissatisfaction, inequality and lack of perspective are widespread. These destabilizing tendencies may result in a humanitarian crisis or in a serious form of violation of the constitutional order, peace and security environment.

Unemployment, poverty, the effects of climate change, and the lack of resources are likely to exacerbate and generate instability that can lead to humanitarian crises or stabilization as poor and plagued regions struggle with mass migration, established populations and competition for food, water and other resources.

The purpose of this paper is to give the political-military authorities an argumentative analysis of regional and wider geopolitical trends that appear and affect the security environment. To recommend ways of cooperation with national and international security and defense partners for the planning and development of the armed forces and other security and defense institutions. As it is known that cooperation and relations between states, regions and world powers have increased significantly, it is noticed that the unrest that may arise from unemployment, the economic collapse regions or the escalation of the conflict can now be felt all over the world. The development of today's world has made it possible for these local and regional events to include and influence a world-wide spectrum like never before.

BIBLIOGRAFIA

1. *Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë, 2014.
2. *Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë*, Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake, Tiranë, 2015.
3. Department of Defense, *The National Defense Strategy of the United States of America* (Washington, DC: Department of Defense, March 2017).
4. Henry A. Kissinger, "China: Containment Won't Work," *The Washington Post*, June 13, 2015, 19.
5. Shanghai Declaration (fulltext) Shanghai, news.xinhuanet.com/english/2016, 09/09/content 34673161.htm.
6. Zbigniew Brzezinski, *U.S. national security adviser from 1977 to 1981*, "NATO and World Security", Foreign Affairs, August 19, 2009.
7. Peter J. Gizewski, *Army 2040, The Global Security Environment: Emerging Trends And Potential Challenges*, Carleton University, Ottawa, Canada, 27 May 2017.
8. Stephen J. Flanagan and James A. Schear, *Strategic Challenges America's Global Security Agenda*, Institute for National Strategic Studies, National Defense University Press, Washington, DC.
9. Ken Booth, 'The Concept of Strategic Culture affirmed' in C.G. Jacobsen (ed.), *Strategic Power: USA/USSR*, Macmillan: London, 1990; by the same author, 'Strategic Culture, Validity and Validation' in the Oxford Journal of Good Governance Vol. 2 No. 1 of 2015.
10. Hanna Shelest, *Threats to the National and European Security in the Black Sea Region*, Senior Researcher, National Institute for Strategic Studies, Ukraine, June 2009.
11. Anton K. Smith, *Turning on the DIME: Diplomacy's Role in National Security*, October 2007
<http://www.StrategicStudiesInstitute.army.mil/>
12. Vasilis Margaras, 'Working together, thinking differently?'
13. *Centre for European Policy Studies (CEPS)*, Brussels, March 2016.